

UNMIK/REG/2007/4  
15 janar 2006

---

**RREGULLORE NR. 2007/4**

**MBI SHPALLJEN E LIGJIT  
PËR MBROJTJEN NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE NGA  
FATKEQËSITË TJERA TË MIRATUAR NGA KUVENDI I KOSOVËS**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në bazë të autorizimit që i është dhënë me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (RKSKB) 1244 (1999) të datës 10 qershor 1999,

Në përputhje me kapitullin 8.1 dhe me nenet 9.1.44 dhe 9.1.45 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Duke marrë parasysh komunikatën e Kryetarit të Kuvendit të Kosovës të datës 21 qershor 2006 lidhur me Ligjin mbi mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 1 qershor 2006,

Duke ditur se dispozitat e Ligjit nuk e cenojnë pushtetin e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm sipas RKSKB-së 1244 (1999) apo kompetencat dhe përgjegjësitë e tij të rezervuara sipas Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë,

Me anë të kësaj shpall Ligjin mbi mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë tjera (Ligji nr. 02/L-68) të miratuar nga Kuvendi i Kosovës që i është bashkëngjitur kësaj Rregulloreje dhe hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit, me kusht që:

(a) Dispozitat në paragrafët (v) dhe (vii) të nenit 25 si dhe (iv), (v) dhe (vi) të nenit 53 të zbatohen në përputhje të plotë me kapitullin 8 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë;

(b) Fjala “kundërvajtje” të zëvendësohet çdokund në kapitullin XV me fjalën “shkelje”.

Ndryshimet e lartpërmendura do të paraqiten në tekstin përfundimtar zyrtar të Ligjit.

Nënshkruar sot, më 15 janar 2007.

Joachim Rücker  
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm